



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E OBJEKTEVE PUBLIKE
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____, _____, 2020

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Datë 24.12.2020

Nga: Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Tiranë.

Për: Operatorin ekonomik: **Luar Bros shpk, NIPT L72322004M**

Adresa: Tiranë, Bulevardi Gjergj Fishta, Qendra Alpas, Shkalla 2, Kati 2, Apartamenti nr.1

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-81061-12-03-2020

Procedura e prokurimit: Kërkesë për propozime

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje vegla dezinfektimi ULV Fogger”, kohëzgjatja e kontratës deri **10 ditë** nga nënshkrimi i kontratës.

Fondi limit: 880 000 (tetëqind e tetëdhjetë mijë) Lekë pa Tvsh

Burimi i Financimit: Buxheti i Bashkisë Tiranë

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 14.12.2020

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara si më poshtë:

1. Operatori ekonomik **Luar Bros sh.p.k** me **NIPT L72322004M** me ofertën ekonomike me vlerë **818 400 (tetëqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind) lekë pa TVSH.**
2. Operatori ekonomik: “**Frozer**” sh.p.k me **NIPT M01629004C**, me ofertë ekonomike me vlerë **850 000 (tetëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.**
3. Operatori ekonomik: “**Alpen Pulito**” shpk me **NIPT K61516506H**, me ofertë ekonomike me vlerë **627 500 (gjashtëqind e njëzet e shtatë mijë e pesëqind) lekë pa tvsh.**

Janë skualifikuar operatorët e mëposhtëm:

Operatori ekonomik: “**Alpen Pulito**” shpk me NIPT **K61516506H**, për këto arsye;

1. • Autorizimi i prodhuesit nuk është paraqitur në origjinal por vetëm fotokopje me vërtetim përkthimi dhe në dokumentin fotokopje të paraqitur nuk ka asnjë element për datën e lëshimit të tij dhe afatin. Rrjedhimisht nuk plotëson kërkesat e paragrafit të fundit të Kriterëve të Veçanta të DST.
2. • Çertifikata CE e produktit është paraqitur e papërkthyer dhe e pa noterizuar. Rrjedhimisht nuk plotëson kërkesat e paragrafit të tretë të Kriterëve të Përgjithshme të DST.
3. • Nuk ka paraqitur raport testimi për plotësimin e standarteve shqiptare të kërkuara në DST. Rrjedhimisht nuk plotëson kërkesat e pikës 2.3 e) të Kriterëve të Veçanta të DST.
4. • Nuk ka paraqitur vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri për Muajin Tetor 2020. Vërtetimi me nr.2105/1 Prot. datë 16.10.2020 i lëshuar nga FSHU konfirmon vetëm shlyerjen për detyrimet deri në Muajin Shtator 2020. Rrjedhimisht nuk plotëson kërkesat e pikës 2 dh) të Kriterëve të Veçanta të DST.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin **Luar Bros sh.p.k** me NIPT **L72322004M** me seli në adresë: Tiranë, Bulevardi Gjergj Fishta, Qendra Alpas, Shkalla 2, Kati 2, Apartamenti nr.1, me ofertë ekonomike **818 400** (*tetëqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind*) **lekë pa TVSH** e paraqitur për tenderin me objekt: “**Blerje vegla dezinfektimi ULV Fogger**”, me afat të lëvrimit deri **10 ditë** nga nënshkrimi i kontratës, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike, Tiranë, Rruga “5 Maji”, Godina 17, Tiranë**, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së njoftimit për lidhjen e kontratës nga AK.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, operatorit ekonomik “Frozer” sh.p.k me NIPT M01629004C, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej 850 000 (*tetëqind e pesëdhjetë mijë*) **lekë pa TVSH**, siç parashikohet në nenin 58 pika 4 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë më datë 16/12/2020

Ankesa: Nuk ka pasur.

TITULLARI AUTORITETIT KONTRAKTOR

Erindi Bejko